

UNIVERSITETI I ARTEVE
SENANTI AKADEMIK

VENDIM

Nr. 1 Datë 10/01/2020

**“PËR SHPËRNDARJEN E GRANTIT TË AKORDUAR NGA MINISTRIA E
ARSIMIT SPORTIT & RINISË DHE REGJISTRIN E PROKURIMEVE ME BURIM
FINANCIM GRANTI, NË UNIVERSITETIN E ARTEVE, PËR
VITIN KALENDARIK 2020”.**

Në zbatim të nenit 3, pika 3 dhe nenit 49 e vijim ...të Ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Senati Akademik pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Administratorja e Universitetit të Arteve, Znj. Alma Sinanaj për “Shpërndarjen e grantit të akorduar nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe regjistrin e prokurimeve me burim financimi granti”, pas diskutimeve dhe me votim të hapur,

VENDOSI:

1. Shpërndarjen e grantit të akorduar nga Ministria e Arsimit, Sportit & Rinisë, për vitin kalendarik 2020 në Universitetin e Arteve, sipas tabelës Nr.1 bashkëlidhur këtij vendimi;
2. Miratimin e regjistrin të prokurimeve me burim financimi granti, për vitin kalendarik 2020 në Universitetin e Arteve, sipas tabelës Nr.2 bashkëlidhur këtij vendimi;
3. Ky vendim të publikohet në faqen zyrtare dhe të dërgohet në Ministri të Arsimit Sportit dhe Rinisë.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

